

VENDIM
Nr. 610, datë 24.7.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Lidhja nr. I “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrave të linjës, institucione qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr. II “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale dhe vendore”, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pas pikës 19 shtohet pika 19/1 me këtë përmbajtje:

“19/1 Për një periudhë transitorë, punonjësit aktualë, që përfshihen në “Projekti hidrik dhe kanalizimet e Tiranës së Madhe”, “Ujësjiellësi dhe ujërat e përdorura, Shkodër dhe Koplik”, “Projekte me KfW”, “Projekte të programit IPA” dhe “Projekti i shërbimeve esenciale”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve, do të trajtohen në pagë, si më poshtë vijon:

- Drejtuesi i projektit (Koordinatori) barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a, në ministri.

- Specialistët barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-b, në ministri.

Përgjashtimisht deri në datën 1 gusht 2013, vlerat e pagave për kategoritë II-a dhe III-b, me të cilat do të trajtohen këta punonjës, të jenë sipas vendimit nr. 524, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave.

ç) Në lidhjen I/1 “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e ministrave të linjës, institucioneve të pavarura e kushtetuese, institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, të përmendur në pikën 4, bëhen ndryshimet e shtesat e mëposhtme:

- Në klasën IV shtohet emërtesa “punëtor mirëmbajtjeje”;

- Në klasën III emërtesa “punëtor mirëmbajtës” shfuqizohet;

- Në klasën VIII, emërtesat “bibliotekar në ministritë e linjës” dhe “ndihmësinsektor”, shfuqizohen.

2. Emërtesa “ndihmësspecialist” të vazhdojë të jetë pjesë e lidhjeve përkatëse të këtij vendimi, deri më 31 dhjetor 2013.

3. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore të përballohen:

- nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për politikat e pagave për vitin 2013, për efekt të rritjes së pagave për çdo klasë, dhe do të fillojnë nga data 1 gusht 2013.

- nga fondet e miratuara për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për efekt të parashikimit të pikës 19/1.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. I

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, NË
KRYEMINISTRI, INSTITUCIONE TË PAVARURA, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS,
INSTITUCIONE QENDRORE NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË LINJËS DHE
NË PREFEKTURA

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	22000
2	II	23750
3	III	25000
4	IV	25650
5	V	26800
6	VI	28900
7	VII	30500
8	VIII	33600
9	IX	36500
10	X	38000

Lidhja nr. II

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË INSTITUCIONET RAJONALE DHE VENDORE

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	22000
2	II	23750
3	III	25000
4	IV	25650
5	V	26800
6	VI	27800
7	VII	28400
8	VIII	29200
9	IX	30200
10	X	31700
11	XI	32000
12	XII	34000
13	XIII	35000
14	XIV	36500